



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:261687
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06248392

K.Dh.Sh.II.nr.189/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N.T.P “Haxhijaha” me seli në Rahovec, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokat Zyhdi Axhemi, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.5/22, të datës 22.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 03.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.P “Haxhijaha” me seli në Rahovec, e datës 30.01.2023, ndërsa Aktgjykimi Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, KF.nr.5/22, i datës 22.12.2022, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës –Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Haxhijaha” me seli në Rahovec, dhe ka mbetur në fuqi aktvendimi nr.06.2/741-2016 i datës 06.11.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve dhe mosrespektimit të rregullave të procedurës, me propozimin që të aprovohet ankesa e N.T.P “Haxhijaha” me seli në Rahovec si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale i dhomave të Shkallës së parë si i pabazuar dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës ne kthimin e shumës prej 17,125.13€ të paguara më tepër në emër të kamatës kompensuese, duke ia shtuar mjeteve të kthimit kamatën ligjore 8% prej datës së inkasimit deri të data e përmbartimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-

së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës, nr.06.2/741-2016 të datës 06.11.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë N.T.P “Haxhijaha” - Rahovecë, me numër fiskal 600039079, për rishqyrtimin e vendimit nr.23217 i datës 26.08.2019 i lëshuar nga ZBD – Prizren.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 06.2/741-2016 të datës 06.11.2019. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se Gjykata konstaton se e paditura ka vepruar drejtë kur ka konstatuar se Zyra doganore ka vepruar drejtë kur subjektit në procedurë i ka caktuar pagesën e kamatës kompensuese për vendosjen e mallit më qarkullim të lire, pasi që subjekti në procedurë shumë qartë në autorizimin e lëshuar për procedurën e përpunimit të brendshëm IM në pikën 11 e kishte caktuar afatin e shkarkimit që ishte 6 muaj nga data e vendosjes së mallit në procedurën e përpunimit të brendshëm, andaj duke qenë se subjekti nuk e ka respektuar këtë afat dhe nuk e ka njoftuar dogënën lidhur me statusin e mallit në fjalë, të njëjtën e ka obliguar që konform menit 125 të KDAK-së dhe nenit 297 të UA 11/2009. Po ashtu kjo gjykatë ka vlerësuar se dogana e Kosovës me të drejtë ka konstatuar se subjekti në procedurë është dashur që t’i përmbahet kushteve të autorizimit që kanë të bëjnë me periudhën e shkarkimit të procedurës dhe të ndërmer veprimet e nevojshme për të njoftuar doganën për çdo vështirësi për përmbushjen e autorizimit apo pamundësisë së vendosjes së mallit në procedurën e përpunimit, dhe në këtë kuptim Dogana e Kosovës i ka bërë me dije subjektit se kamata kompensuese është paraparë me dispozitat ligjore nga neni 125 i KDAK-së, dhe neni 297 i UA 11/2009, dhe në këtë kuptim zyra doganore ka vepruar drejtë kur ka aplikuar kamatë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të fakteve, pasi që ndërprerja e kontratës për ri eksport me Kroacinë, ka qenë shkaku ku si pasojë janë përpjekjet e pareshtura të pasuksesshme të subjektit ankimor lidhur më ofertimin e produktit të verës brenda dhe jashtë vendit, andaj ka qenë i detyruar që ta lëshoj mallin në qarkullim të lirë duke i paguar detyrimet e importit. Këtë konstatim kolegji i kësaj gjykate e konsideron si të pabazuar për faktin se kamata e caktuar për mallin lidhet me vonesën që mallit t'i jepet trajtimi doganor, pra është çështje procedurale të cilën subjekti nuk e ka respektuar, dhe paditësi nuk mund të thirret ne faktin se mosveprimi që është dashur të ndërmerret nuk është varur nga ai, ngase pavarësisht këtij fakti, i njëjti ka mundur që të parashtroj kërkesë tek dogana e Kosovës qoftë për zgjatje të afatit të importit të përkohshëm qoftë për dhënien e një trajtimi tjetër të lejuar doganor.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 195 par. 1 pika (d) e LPK-së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.189/23, me datë 03.10.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova